

# Ligji për minierat, debate në Kuvend

SHEKULLI | 25/05/2010 | BIZNES |  0 KOMENTE |  SHARE | -  + 

Deputetët propozojnë ndryshime thelbësore në ligjin për minierat të propozuar nga METE TIRANË- Ligji i ri për minierat në vend është bërë shkak për debate në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese në Kuvend.

Deputetët kanë debatuar për disa minuta me radhe ndërmjet tyre dhe Drejtorit të Politikave Industriale në Ministrinë së Ekonomisë Sokol Mati në lidhje me përcaktimet që jepte ligji për sa i përket dhënies në lejës për kërkimin dhe shfrytëzimin e hapësirave tokësore nga investitorët e interesuar në këtë fushë.

Propozimi i Ministrisë së Ekonomisë i cili është pasqyruar edhe në ligj parashikon ndarjen e lejeve për aktivitetin e kërkimit dhe atë të zbulimit duke e arsyetuar me faktin se kjo do të bëjë që një subjekt të mos e mbajë për shumë kohë të bllokuar një sipërfaqe tokësore pa shfrytëzuar. Nga ana tjetër, anëtarët e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese kanë kërkuar bashkimin e këtyre lejeve në një të vetme duke i lehtësuar sipas tyre punën investitorëve.

Madje kreu i Komisionit, Jemin Gjana, sugjeroi heqjen e detyrimit për marrjen e lejes për kërkim duke i lejuar gjithkujt që ta zhvillojë këtë aktivitet. Sipas tij, leje pranë METE-s duhet marrë vetëm në momentin që subjekti vendos të fillojë zbulimin për mineral.

Kjo ka hasur në kundërshtimin e përfaqësusit të METE-s Sokol Mati, i cili nuk ka mbështetur një ndryshim të tillë në ligj duke vënë theksin tek fakti se në rastet kur jepet leja për kërkim ndaj një subjekti ajo i bëhet me kushtin që të dhënat që përfiton t'ia ofrojë shtetit ndërsa nëse liberalizohet ky proces këto materiale atëherë asnjë subjekt nuk do të jetë i detyruar që të dhënat e akumuluar t'ia japë ministrisë.